



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.28.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AUTORITETIT KOSOVAR TË
KONKURRENCËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga, Adelina Selmani (Udhëheqës Ekipi) dhe Laureta Matoshi (anëtare).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	11
4 Qeverisja	12
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	20
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	23


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë falënderoj Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, datës 14/10/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

(ISSAI 200/1705 Opinion i Pamodifikuar)


Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si Theksim i çështjes – dëshirojmë të përmendim faktin se në shënimet shpjeguese AKK nuk ka shpalosur vlerën e pasurive jokapitale nën 1,000€. Kjo nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme dhe Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

(SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigje nga Menaxhmenti - auditimi i vitit 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Draft PVF-të e pranuar nga AKK pas disa këshillave të dhëna nga ne, janë korrigjuar. PVF-të e korrigjuara kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara të Sektorit Publik “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Rregullës Financiare nr. 06/2011, në përjashtim të pasurive nën 1,000€.

Marr parasysh atë më lartë- Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, pas korrigjimeve të bëra mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë, në përjashtim të shpalosjeve për pasurit nën 1,000€.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si Theksim i çështjes – dëshirojmë të përmendim faktin se në shënimet shpjeguese, AKK nuk ka shpalosur vlerën e pasurive jokapitale nën 1,000€. Kjo nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme dhe Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

(SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, e datës 14/10/2014, nuk janë identifikuar rreziqe domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive. Gjatë kryerjes së auditimit, ne kemi identifikuar mos shpalosjen e pasurive nën 1,000€ në PVF. Këto janë rreziqe nga të cilat mund të rezultojë Theksimi i Çështjes.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1- Mos shpalosja e pasurive nën 1,000€ në PVF 2014

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për t'a dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive nën 1,000€ për vitin 2014. Vlera prej 17,400€ e regjistruar në e- pasuri nuk ishte shpalosur në PVF 2014. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate të menaxhmentit.

Rekomandimi 1 Sekretari i Përgjithshëm duhet të analizojë arsyet për mos shpalosjen e pasurive nën 1,000€ në PVF 2014 dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në PVF-të 2015.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

AKK duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullës Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit;
- Plani preliminar dhe final të prokurimit; dhe
- Raportet për borxhet e papaguara.

Megjithatë nga të gjitha kërkesat për raportim që kërkohen nga ligjet dhe rregulloret në fuqi, vetëm raportet për borxhet e papaguara nuk ishin dorëzuar gjatë vitit 2014 në MF.

Çështja 2 – Mangësi në raportimin e obligimeve mujore -Prioritet i mesëm

E gjetura	Faturat e pranuar nga Operatorët Ekonomik (OE) nuk ishin të protokoluara nga AKK si dhe nuk kishin datën e pranimit. Si rezultat i kësaj, AKK nuk kishte të dhëna lidhur me obligimet e saja mujore dhe nuk kishte raportuar asnjëherë në Ministrinë e Financave.
Rreziku	Mungesa e një pasqyre të obligimeve mund të sjellë mos prioritizimin e pagesave dhe si rrjedhojë mund të lindin edhe dënime shtesë për mos respektim të afatit kohor për pagesë nga OE.
Rekomandimi 2	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar protokolohehen. Po ashtu, faturat e pranuar dhe të papaguara raportohen në baza mujore në Ministrinë e Financave sipas rregullës financiare 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Përkundër hartimit të planit të veprimit për ti trajtuar rekomandimet e dhëna, AKK nuk ka arritur t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna nga viti 2013. Si rezultat i mos adresimit i të gjitha rekomandimeve, disa çështje janë përsëritur edhe në këtë vit.

Përshkrimi

Në raportin e auditimit për vitin 2013 janë dhënë nëntë (9) rekomandime. AKK ka hartuar planin e veprimit për adresimin e tyre. Plani i veprimit paraqet bazë për monitorimin e efektivitetit të adresimit të rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, pesë(5) rekomandime janë adresuar plotësisht, një (1) është adresuar pjesërisht, dhe tri (3) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Plani për adresimin e rekomandimeve nuk ka gjetur zbatim plotësisht në të gjitha fushat për arsye se mangësi të njëjta vazhdojnë të jenë prezente edhe në 2014. Rekomandimet lidhur me fushën e raportimit, shërbimet e telefonisë, plotësimi i pozitave të lira dhe menaxhimi i automjeteve janë pjesërisht apo nuk janë adresuar fare.
- Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë rezultuar në jo efikasitet të kontrolleve të brendshme, dhe si rezultat i saj kemi përsëritjen e mangësive të njëjta si në vitet paraprake.
- Rekomandimi 3** Sekretari i Përgjithshëm duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e adresimit të rekomandimeve të AP-së, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për adresimin e rekomandimeve.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga AKK si në vazhdim:

- Vetëvlerësimi –është zbatuar formalisht mirëpo nuk është vënë në funksion për të shërbyer si pikënisje për të zhvilluar sisteme efektive të MFK-së si dhe për të përmirësuar performancën e përgjithshme të AKK-së .
- Menaxhimi i rrezikut – AKK ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara për identifikimin e rreziqeve.
- Raportimi i brendshëm/ kontrollet menaxheriale nuk janë plotësisht funksionale për të adresuar mangësitë me kohë.

Megjithatë ne vlerësojmë se ekziston nevoja që ky vetëvlerësim të vihet në funksion për të përmirësuar kontrollet në menaxhimin e shpenzimeve të telefonisë mobile, udhëtimeve zyrtare dhe në procedimin e pagesave brenda afatit kohor ligjor. Rreziqet lidhur me menaxhimin e dobët të automjeteve duhet të identifikohen dhe masa konkrete të ndërmerren me qëllim që të parandalohet mundësia për keqpërdorimin e tyre.

Realizimi i përgjithshëm i buxhetit në masë prej 74% nuk është në nivelin e kënaqshëm. Megjithatë, suficiti ishte jashtë kontrollit të AKK-së për shkak të hapësirës së pamjaftueshme në objektin ekzistues. Kjo ka pamundësuar rekrutimin e stafit të aprovuar me Ligjin e Buxhetit dhe furnizimit me mallra dhe shërbime të planifikuara me planin vjetor. Po ashtu edhe mungesa e Bordit drejtues ka ndikuar në mos shpenzimin e buxhetit.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Struktura organizative përbëhet nga Kryesuesi i Bordit dhe 4 anëtarë. Bordi është jofunksional për arsye të skadimit të mandatit të anëtarëve të tij. Edhe pse agjencioni ka një strukturë të thjeshtë organizative me një numër të vogël stafi, është me rëndësi që menaxhmenti në AKK të prezantoj nivel më të lartë të kontrolleve monitoruese menaxheriale.

Çështja 4 - Aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes - Prioritet i Lartë

E gjetura Menaxhmenti i AKK-së nuk mban takime të rregullta me zyrtarët në zingjirin llogaridhënës, së paku kjo nuk është dokumentuar në formën e një procesverbali ose në formën e raporteve. Po ashtu, mungon edhe raportimi me shkrim i dokumentuar nga zyrtarët për buxhet dhe financa dhe burime njerëzore. Këto kanë ndikuar që kontrollet të jenë jo efektive në veçanti në fushën e pagesave, menaxhim të pasurisë si dhe menaxhimin e automjeteve.

Më tutje, AKK nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve (regjistri i rreziqeve) në nivel të organizatës që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen objektivave.

Rreziku Mos mbajtja e takimeve të rregullta, mungesa e dokumentimit të raportimit si dhe mos identifikimi i rreziqeve mund të rezultojë në zvogëlimin e aftësisë së menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj sfidave, si dhe në mos përmbushjen e objektivave të organizatës me kohë.

Rekomandimi 4 Sekretari i Përgjithshëm duhet të shqyrtojë aranzhimet ekzistuese të raportimit për të siguruar që mangësitë identifikohen dhe raportohen me kohë me qëllim të evitimit të tyre.

Po ashtu të siguroj që ka zhvilluar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve (regjistri i rreziqeve) për të zvogëluar ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen objektivave.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për AKK-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	255,043	198,268	147,477	187,471	194,165
Granti i Qeverisë -Buxheti	255,043	198,268	147,477	187,471	194,165

Tabela 1 tregon se buxheti fillestar si rezultat i shkurtimeve buxhetore është zvogëluar për 56,775€. Realizimi i buxhetit për vitin 2014 arrinte në shkallën 74%. Krahasuar me vitin 2013 realizimi i buxhetit ka shënuar rënie prej 15%.

Për dallim nga tabela e parë, tabela 2 prezanton ekzekutimin e buxhetit për kategori ekonomike.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	255,043	198,268	147,477	187,471	194,165
Pagat dhe Mëditjet	166,616	123,105	100,587	107,038	100,040
Mallrat dhe Shërbimet	82,727	70,318	44,897	77,985	92,005
Shërbimet komunale	5,700	4,845	1,992	2,448	2,120

Buxheti final për Paga dhe Mëditje krahasuar me buxhetin fillestarë është zvogëluar për 43,511€ apo për 15% me vendim të Qeverisë të datës 05.11.2014. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar 81%.

Buxheti final për Mallra dhe Shërbime krahasuar me buxhetin fillestarë është zvogëluar për 12,409€ apo 15% po ashtu me vendim të Qeverisë të datës 27.02.2014. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar 63%.

Buxheti final për Shërbime Komunale krahasuar me buxhetin fillestarë është zvogëluar për 855€ po ashtu me vendim të Qeverisë të datës 27.02.2014. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar 41%.

Realizimi i përgjithshëm i buxhetit në masë prej 74% nuk është në nivelin e kënaqshëm. Megjithatë, ky rezultat i mos shpenzimit të buxhetit ishte bukur shumë jashtë kontrollit të AKK-së

për shkak se hapësira e pamjaftueshme në objektin ekzistues ka pamundësuar rekrutimin e stafit të aprovuar me Ligjin e Buxhetit. Po ashtu edhe mungesa e Bordit drejtues ka ndikuar në mos shpenzimin e buxhetit.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Ne kemi testuar pagesat në vlerë prej 35,551€ nga kategoria mallra dhe shërbime. Ne vlerësuam gjithashtu pajtueshmërinë e procedurave të prokurimit tek 5 procedura prokurimi për vitin 2014 dhe vlerësuam se ato ishin kryer në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

Megjithatë ekzaminimet tona kanë identifikuar disa mangësi në procedimin e pagesave dhe në aprovimin e udhëtimeve zyrtare.

Çështja 5 - Mangësi në menaxhimin e shpenzimeve dhe në procedimin e pagesave - Prioritet i Lartë

E gjetura **Marrja e shërbimeve të telefonisë pa procedura të prokurimit.** Shpenzimet e telefonisë mobile për vitin 2014 ishin në vlerë prej 5,020€. Në raportet e auditimit për dy vitet e fundit radhazi është rekomanduar lidhja e kontratës për shërbime të telefonisë mobile përmes procedurave të hapura me qëllim që të siguroj shërbime me kosto më të ulët. AKK vazhdon furnizimin me kartela mbushëse nga operatori Vala.

Vonesë në ekzekutimin e pagesave. Organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Në nëntë (9) raste faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë prej 8,856€ nuk ishin paguar brenda afatit ligjor.

Rreziku Mos aplikimi i procedurave të hapura të prokurimit për shërbime të telefonisë rritë rrezikun për shërbime jo efikase dhe dështimin për të arritur vlerën për para. Po ashtu, mos pagesa me kohë e obligimeve mund të ndikoj në humbjen e kredibilitetit të AKK-së ndaj operatorëve ekonomik.

Rekomandimi 5 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka kryer një rishikim të brendshëm për të përcaktuar se pse kërkesat e prokurimit për telefoni mobile nuk janë aplikuar dhe po ashtu të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se të gjitha faturat paguhen me kohë.

4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Ne kemi testuar gjithashtu shpenzimet për të cilat nuk kërkohet aplikimi i procedurave të prokurimit siç janë mëditjet për udhëtime zyrtare, shpenzimet e telefonisë mobile, komunalit. Kontrollat rreth këtyre shpenzimeve kanë funksionuar në përjashtim të çështjes në vijim.

Çështja 6 - Shpenzimet e udhëtimit- Prioritet i mesëm

E gjetura AKK kishte konfirmuar pjesëmarrjen e katër Inspektorëve të Departamentit për Mbikëqyrjen e Tregut në trajnimin “Draftimi i rregulloreve, diskutimi me palët e interesit dhe mbrojtja ligjore e rasteve para Gjykatës Administrative” të organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës në Shqipëri me datën 19-20 qershor 2014. Përveç katër inspektorëve kishin marrë pjesë edhe katër zyrtarë tjerë të AKK-së duke qëndruar dy netë. Shpenzimet në total për këtë udhëtim ishin në vlerë 4,162€.

Rreziku Shfrytëzimi i buxhetit për udhëtime zyrtare pa ndonjë analizë paraprake lidhur me përfitimin dhe koston e tyre rrit rrezikun që kostoja e pjesëmarrjes nuk do të jetë ekuivalent me përfitimin dhe nuk e justifikon shpenzimin e bërë.

Rekomandimi 6 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që ka forcuar kontrollat gjatë aprovimit të udhëtimeve zyrtare duke shqyrtuar me kujdes nevojën për pjesëmarrje të stafit, në mënyrë që kostoja e pjesëmarrjes të jetë ekuivalent me përfitimet.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Në AKK gjatë vitit 2014 ishin 13 të punësuar nga 23 sa parasheh Ligji për Buxhet. Shpenzimet për Paga dhe Mëditje paguhen përmes sistemit të centralizuar qeveritar (payroll).

Duhet të theksohet se krahas detyrave të caktuara secili zyrtar kryen edhe detyra shtesë në menaxhimin e parasë publike. Ndarja e detyrave të caktuara është munduar të bëhet në përshtatshmëri me kapacitetet aktuale, megjithatë këto mundësi nuk janë shfrytëzuar plotësisht dhe kjo mund të ndikojë në kontrollin joefikas në procesin e shpenzimeve.

Çështje 7- Avancimi në pozitë pa aplikimin e procedurës për avancim - Prioritet i lartë

- E gjetura** Vendimi për transferimin e asistentes ekzekutive në pozitën e zyrtares së lartë të personelit nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8) ishte bërë pa aplikuar procedurat për avancim. AKK nuk ka shpallur konkurs të brendshëm për t'i mundësuar qasje të gjithë nëpunësve civil siç e përcakton Ligji për shërbyes civil neni 27 dhe rregullorja nr.21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civil.
- Rreziku** Ngritja në pozitë në mënyrë automatike pa respektimin e procedurave për avancim, rrit rrezikun e avancimit të punonjësve pa aftësitë dhe kualifikimet e duhura.
- Rekomandimi 7** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që me rastin e avancimit respekton procedurat e përcaktuara me rregulloren nr.21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civil.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Sipas regjistrit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1000€) ishte 22,233€ ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) sipas shënimeve nga e-pasuria ishte 17,536€.

Auditimi jonë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi çështjet në vijim.

Çështja 8 - Mos inventarizimi i pasurisë - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas rregullës së thesarit nr. 02/2013 neni 18, obligohet që çdo organizatë buxhetore të bëjë inventarizimin e pasurisë së organizatave buxhetore. AKK nuk ka bërë inventarizimin e pasurisë së saj për vitin 2014.
- Rreziku** Në mungesë të inventarizimit mund të mos kemi një pasqyrë të saktë në numrin ose në vlerën e pasurive e që pastaj duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.
- Rekomandimi 8** Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se kryhet inventarizimi i pasurisë çdo fund vit, për të qenë në dijeni të gjendjes së pasurisë të cilën e zotëron AKK-ja.

Çështja 9 - Mangësi në menaxhimin e automjeteve - Prioritet i lartë

- E gjetura** AKK përkundër rekomandimit tonë për dy vite radhazi ende nuk ka vënë në funksion kontrolle adekuate për menaxhimin e automjeteve zyrtare. AKK posedon pesë (5) automjete. Evidencat për relacionin e shfrytëzimit të automjeteve, kilometrat e kaluara, derivatet e shpenzuara nuk janë mbajtur nga asnjë zyrtar. Mënyra e shfrytëzimit të tyre dhe pamundësia që ne të kemi një informatë tregon për mosfunksionim të kontrollit dhe mungesë të llogaridhënies.
- Rreziku** Mungesa e evidencave për kohën e shfrytëzimit dhe destinacionit mund të rris rrezikun se automjetet nuk përdoren vetëm për qëllime zyrtare.
- Rekomandimi 9** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që automjetet zyrtare janë menaxhuar në përputhje me udhëzimin administrativ.

4.4.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

AKK në fund të vitit 2014 nuk kishte asnjë obligim për të raportuar. Të gjitha faturat e pranuar ishin paguar deri më 31 Dhjetor 2014.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Duke marr parasysh kriteret për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm brenda një institucioni publik AKK nuk plotëson këtë kriter as në bazë të buxhetit dhe as në bazë të numrit të punëtorëve. Megjithatë, me qëllim që t'i ndihmoj AKK-së në forcimin e kontrollit të brendshëm, Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB) në MF ka kryer një auditim në AKK për periudhën Janar-Dhjetor 2013 dhe Janar-Maj 2014.

Rekomandimet

Çështja 10 - Mos përgatitja e planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm - Prioritet i lartë

E gjetura Auditimi nga DAB në MF ka mbuluar auditimin e shpenzimeve në përgjithësi dhe kontrollet e vendosura nga AKK për realizimin e misionit dhe objektivave të parapara me legjislacionin në fuqi. Nga auditimi ishin identifikuar mangësi të njëjta me ato të cilat ne i identifikuam gjatë auditimit tonë, në veçanti, menaxhimi i automjeteve dhe udhëtimeve zyrtare.

Rreziku Mos adresimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm ndikon në mos efikasitet në kontrole të brendshme dhe humbjen e kredibilitetit të AKK-së ndaj akterëve të jashtëm.

Rekomandimi 10 Sekretari i Përgjithshëm ka trajtuar me kujdes çështjet e paraqitura në raportin e auditimit të DAB-së me qëllim të ngritjes së kontroleve të brendshme.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të AP-së me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga menaxhmenti në baza të rregullta.		Pjesërisht e adresuar	
4.4.Shpenzimet – Prokurimi Zhvillimi i procedurave të prokurimit në mungesë të deklaratës për disponueshmërinë e fondeve - Prioritet i mesëm	Kryetari i Bordit duhet të siguroj që para fillimit të aktivitetit të prokurimit të plotësohet forma për deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, dhe të nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët përgjegjës.	E adresuar		
4.4.Shpenzimet – Prokurimi- Mos informim i OE-së së pasuksesshme - Prioritet i mesëm	Kryetari i Bordit duhet të shqyrtoj mundësinë që përmes procedurave të prokurimit të lidhë kontratë për shërbime të telefonisë mobile. Lidhja e kontratës do të siguroj shërbime me kosto më të ulët.			E pa adresuar

4.4.Shpenzimet - Prokurimi Regjistrimi në SIMFK pas pranimit të faturës - Prioritet i mesëm	Kryetari i Bordit duhet të siguroj një proces të përhershëm të informimit të OE-së e pasuksesshëm. Kjo do ta zhvilloj transparencën dhe konkurrencën në blerje, dhe me këtë rast të njëjtëve ju ofrohet mundësia e ankesës.	E adresuar		
4.4 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari i Bordit duhet të forcoj kontrollet financiare lidhur me menaxhimin e avanseve. Të gjithë personat që shfrytëzojnë avanse, të bëjnë barazimet e duhura brenda periudhës së kërkuar ligjore	E adresuar		
4.5 Pagat dhe medijtjet	Kryetari i Bordit duhet të siguroj se janë marrë masa konkrete për plotësimin e vendeve të lira të punës, me qëllim të përmbushjes së objektivave dhe misionit			E pa adresuar
4.5 Pagat dhe medijtjet	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se të gjitha vendimet lidhur me punën provuese, merren nga menaxhmenti i autorizuar për këtë qëllim	E adresuar		
4.5 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë masat e duhura që para përfundimit të mandatit të secilës pozitë, të bëjë kthimin e pasurive nga zyrtarët e ngarkuar me pasurinë në fjalë.	E adresuar		
4.5 Pasuritë dhe detyrimet	Mos respektimi i U.A nr.03 / 2008 gjatë shfrytëzimit të automjeteve - Prioritet i lartë			E pa adresuar